



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:115757
Datë: 01.06.2024
Numri i dokumentit: 05780394

C.nr.459/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: S.Z, D.A-S, SH.M, A.F dhe XH.SH, që të gjithë nga M..., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Leutrim Ademi, avokat nga M..., kundër të paditurës: Komuna e Mitrovicës Jugore - D..A., me seli në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson Arbnor Murturi avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi inflacioni në pagë, pas mbajtjes se seancës kryesore publike, jashtë seancës gjyqësore me datë 01.06.2024, nxjerr këtë:

**AKTGJYKIM
NË BAZË TË POHIMIT**

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: S.Z, D.A-S, SH.M, A.F dhe XH.SH, që të gjithë nga M..., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-D..K..A., që paditësve, në emër të kompensimit të shujtave ushqimore për periudhën kohore 12.03.2020 e deri me 30.12.2020 t'ia kompensoj shumat si në vijim:

- Paditëses: S.Z, për 80 ditë të prezencës në punë (nga 2 euro dita), shumën prej 160€ (*njëqind e gjashtëdhjetë euro*);
- Paditëses: D.A-S, për 80 ditë të prezencës në punë (nga 2 euro dita), shumën prej 160€ (*njëqind e gjashtëdhjetë euro*);
- Paditëses: SH.M, për 80 ditë të prezencës në punë (nga 2 euro dita) shumën prej 160€ (*njëqind e gjashtëdhjetë euro*);
- Paditësit: A.F, për 75 ditë të prezencës në punë (nga 2 euro dita) shumën prej 150€ (*njëqind e pesëdhjetë euro*);
- Për paditësen: XH.SH, në emër të kompensimit të inflacionit në pagë, për periudhën kohore 06.07.2019 deri me dt.31.10.2020, shumën prej 57.89€ (*pesëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e nëntë cent*)

Për secilën me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë 10.06.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR- kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e procedurës kontesimore ashtu që **OBLIGOHET-** e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditësve shumën prej 1.223,20€, brenda afatit prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR- kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e procedurës kontesimore me te cilën ka kërkuar që të **OBLIGOHET-** e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditësve shumën prej 811.20€, brenda afatit prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit të tij, përmes padisë të datës 10.06.2021, e të precizuar në seancën shqyrtimit kryesor me dt. 10.05.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - D..A., kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve: paditëses: S.Z, shumën prej 160€ (njëqind e gjashtëdhjetë euro), paditëses: D.A-S, shumën prej 160€ (njëqind e gjashtëdhjetë euro), paditëses: SH.M, shumën prej 160€ (njëqind e gjashtëdhjetë euro); paditësit: A.F, shumën prej 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro); për paditësen: XH.SH, në emër të kompensimit të inflacionit në pagë, për periudhën kohore 06.07.2019 deri me dt.31.10.2020, shumën prej 57.89€ (pesëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e nëntë cent).

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.05.2024 i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe kërkojë nga gjykata që të njëjtën ta aprovoi në tërësi si të bazuar si dhe i njëjti i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të hartimit të padisë shumën prej 312 euro në emër të përfaqësimit për katër seanca nga 405.60€, euro(405.60€ x4= 1,622.4€), në emër të ekspertizës financiare shumën prej 80.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës, gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pasi që përfaqësuesi i paditëses e ka precizuar kërkesëpadinë në lidhje me shujtat ushqimore të paditësve, atëherë e paditura nuk e kundërshtoi kërkesën e paditësve në lartësinë e shumave të precizuara si në seancë.

Tutje i njëjti ka deklaruar se kundërshton kërkesën për kompensimin e seancave që janë caktuar dhe mbajtur për fajin e paditësit dhe e paditura i kërkoi shpenzimet për seancën e dt. 10.05.2024 në shumën prej 135€.

Për të vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këtë çështje juridike, në shqyrtimin kryesor - publik të datës 10.05.2024, me propozimin e palëve ndërgjyqëse, gjykata bëri administrimin e këtyre provave:

- Kërkesa për kompensim i shujtës ushqimore drejtuar të paditurës e datës 07.05.2022,
- Vërtetimet e lëshuara në emër të paditësve nga SHME“ Hasan Prishtina” Mitrovice, me nr. të protokollit 314/11,12,13 dhe 15 të gjitha të lëshuar me dt. 07.09.2022,
- Ekspertiza financiare e datës 05.10.2022.
- Lista e pagave të lëshuar në emër të paditësve për muajin Korrik 2019,
- Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë me nr. të rasit C.nr. 791/2021 i dt. 26.01.2023.

Prandaj gjykata ne kuptim te nenit 148 par. 1 të LPK –se me te cilin përcaktohet se: ” Ne qofte se i padituri deri ne përfundim te shqyrtimit kryesor te çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim te mëtejme, aktgjykim me te cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim ne baze te pohimit)” dhe gjykata vendosi pa shqyrtim te mëtejme si ne piken I te dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ne pike I te dispozitivit te këtij Aktgjykimi lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, e në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga dita e paraqitjes se padisë datë 10.06.2021.

Gjykata vendosi si në piken II te dispozitivit, në kuptim të nenit 452 të LPK-së ashtu që e detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë ne emër te hartimit të padisë shumë prej 312 euro në emër të përfaqësimit për dy seanca gjyqësore dhe atë për seancën e dt. 21.09.2022 dhe atë 10.05.2024, në shumë prej 811.20€ (405.60€ x2 = 811.20 €), në emër të ekspertizës financiare shumë prej 80.00€ dhe në emër të taksës shumë prej 20.00€, apo në total shumë e përgjithshme prej 1.223,20€.

Gjykata vendosi në pikën III te dispozitivit të këtij aktgjykimi duke i refuzuar pjesërisht si të pa bazuara shpenzimet e procedurës kontestimore sa i përket seancës se dt. 17.01.2023, në shumë prej 405.60€, e cila është shtyrë me kërkesën e të autorizuarit të paditësve si dhe seancën e dt. 21.12.2022, në shumë prej 405.60€, e cila është shtyrë pa fajin e të paditurës, apo në total shumë e përgjithshme prej 811.20€.

Nga të lartcekurat u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.459/2023, të datës 01.06.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.